



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA FIER**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më 23/ 09/ 2021

**Lënda:** Dërgohet për publikim Formulari i Njoftimit të Fituesit (*PAS PROCESIT TË ANKIMIT*) për procedurën me objekt “**Furnizim vendosje sisteme automatike parkimi për nevojat e Bashkisë Fier**”, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**  
**TIRANË**  
**(për botim)**

---

Shtojca 11

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1**  
**( *PAS PROCESIT TË ANKIMIT* )**

**BASHKIA FIER**

**Data:** 23.09.2021

**Drejtuar:** Operatorik ekonomik “PC STORE” shpk  
Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë

**\*\*\***

Procedura e prokurimit: **E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike.**

Numri i referencës së procedurës / lotit: **REF-97731-06-08-2021.**

---

<sup>1</sup> Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Furnizim vendosje sisteme automatike parkimi për nevojat e Bashkisë Fier**”, me fond limit **4 150 000** (kater milion e njeqind e pesedhjetë mijë) **lekë pa TVSH lekë**, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier, në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e references dhe kushtet e përcaktuara në DST. Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [14 Qershor 2021], [Numri 92].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “FREDI ELECTRONIC”** shpk numri i NUIS K91803020F.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **2 868 800** (dy milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH**.

**2. Operatori ekonomik “K - AKS”** shpk numri i NUIS K52304503K.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **3 775 670.05** (tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë pikë zero pesë) **lekë pa TVSH**.

**3. Operatori ekonomik “PC STORE”** shpk numri i NUIS L01606034A.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **3 776 000** (tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) **lekë pa TVSH**.

**4. B.O.E. “Adi Professional”** shpk numri i NUIS K22113002I & “**FLORIDA**” shpk numri i NUIS J79602604P.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **3 889 040** (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyzet) **lekë pa TVSH**.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Operatori ekonomik “FREDI ELECTRONIC”** shpk numri i NUIS K91803020F.

*Arsyet e mëposhtme:*

Oferta refuzohet pasi nga shqyrtimi i informacionit/dokumentacionit te paraqitur nga ana juaj ne lidhje me shpjegimin e ofertes suaj anomalisht te ulet, KVO nuk bindet se ajo eshte e plote dhe e rregullt ne te gjitha elementet e saj, bazuar ne nenin 93 te LPP-së.

KVO gjykon se nuk janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion mbështetës bindës, që të argumentojë ofertën anomalisht të ulët, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të nenit 93 të LPP-së (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, anës ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së furnizim vendosjes së artikujve objekt prokurimi; zgjidhjeve teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e objektit të prokurimit; origjinalitetin e furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt dhe e plotë në të gjithë elementët e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Duke vlerësuar shpjegimet e operatorit Fredi Electronic shpk në fushën e elektronikës dhe informatikës, KVO nuk bindet në lidhje me zbatimin me rigorizitet të objektit “Furnizim vendosje sisteme automatike për nevojat e Bashkisë Fier”. Operimi i OE si pike shitje me shumicë për pjesë këmbimi të pajisjeve elektronike nuk është bindës dhe nuk justifikon ofertën anomalisht të ulët, pasi një pjesë e zerave të kërkuar nuk janë elektronike. Përsa i përket pretendimit se OE disponon mallra stok që nevojiten për realizimin e këtij objekti prokurimi, AK gjykon se ky fakt përben një argument jobindës në lidhje me cilësinë e këtyre mallrave. Gjithashtu AK nuk është e bindur edhe mbi çmimin e ofertes së Arma Controll të cilën OE e ka bashkelidhur në shpjegimin e ofertes, pasi bie në sy çmimi i barrierave të parkimit sipas metrave përkatës. (barrierat e parkimit 3-4 metra më të shtrënjta se barrierat e parkimit 4-6 metra).

## 2 . Operatori ekonomik “K - AKS” shpk numri i NUIS K52304503K.

### *Arsyet e mëposhtme:*

Operatori ekonomik “K - AKS” shpk skualifikohet në zbatim të Vendimit të KPP-së nr.653/2021 datë 21.09.2021 (*pas rivlerësimit të KVO-së*), për arsyet të mospërbushjes së kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 8 e DST. Operatori ekonomik “K - AKS” SHPK për vitin 2020 rezulton të ketë ushtruar aktivitet edhe në Bashkitë Tiranë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Fier, Kavajë, vende këto të ushtrimit të aktivitetit për të cilat nuk ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me Manualin nr.1, datë 26.01.2018 “*Për Regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimeve elektronik*”, vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, por ka ngarkuar vetëm vërtetimin me nr.7170 protokollin datë 16.06.2021 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, se nuk ka detyrime të palikujduara deri në datën e marrjes së vërtetimit, duke mos përbushur plotësisht kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me kriteret për kualifikim për dorëzimin e vërtetimeve për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha vendet ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitet sipas ekstraktit të QKB.

**\* \* \***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**PC STORE**” shpk me NUIS L01606034A, me adresë Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **3 776 000** (*tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë*) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor **Bashkia Fier, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”**, sigurimin e kontratës dhe të nëshkruani kontratën, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (*pesë*) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës është: **Vendimi i KPP-së nr.653/2021 datë 21.09.2021 (nr.1418/8 prot. datë 21.09.2021).**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

---

**Armando SUBASHI**